



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:031889

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05510946

P.nr.120/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, sipas gjyqtarit të vetëm gjykues Veli Kryeziu, me bashkëpunëtoren profesionale Shqipe Latifi, në lëndën penale ndaj të pandehurve D... A,,,,, L... M.. nga fshati D...dhe F... A.. nga fshati P...K. Gjilanit, për shkak të veprës penale Mosdhënia e ndihmës nga neni 188 paragrafi 1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2024/2024 të datës 29.02.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik të datës 12.03.2024 dhe në prezencë të palëve publikisht shpalli, ndërsa më datën 14.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurve:

1.D.. A... nga i ati A..., e ëma L..., e lindur A... i lindur më ,,në Gjilan, me vendbanim në fsh. D... K. E Gjilanit, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i pa dënuar.

2.L... M.... nga i ati S..., e ëma B..., e lindur S..., i lindur më në Gjilan, me vendbanim në fsh. Dobërqan K. Gjilanit, ka të kryer shkollën e mesme, punon si limar auto ngjyrosës, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i pa dënuar.

2.F....A... nga i ati R... e ëma M..., e lindur L..., i lindur mënë Gjilan, me vendbanim në fsh. Pogragjë K. Gjilanit, ka të kryer shkollën e mesme, vozitës te ndërmarrja Valoni trans, i pa martuar, i gjendjes së varfër ekonomike, me numër personal...., shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i pa dënuar.

JANË FAJTOR

I pandehuri Dionit Avdyli

I.

Më datë 25.Janar 2024, rreth orës 00.58 min ,në fshatin Dobërcan Komuna e Gjilanit , i pandehuri D,,, A.... , me mosveprim nuk i ka ofruar ndihmë përsonit jeta e të cilit ka qenë në rrezik të drejtëpërdrejtë , ashtu që në momentin që ka arritur në hyrje të fshatit Dobërcan , me veturën e tij të markës Golf 6 me tabela të regjistrimit 06-185-FK, në anën e djathtë të rrugës ka parë veturën e markës VË Pasat me tabela të regjistrimit 06-719-AO,e cila posa ishte aksidentuar , i pandehuri ka ndalur veturën e tij në afërsi të veturës së aksidentuar dhe vetëm e ka shikuar veturën ,e më pas ka vazhduar rrugën , duke mos i ofruar ndihmën e nevojshme të dëmtuarit Besar Hoti dhe tani të ndjerit L... Rr... , edhe pse këtë ka mundur t'a bëjë pa rrezik të madh për veten apo për personin tjetër apo edhe të kërkojë ndihmë tek autoritetet përkatëse , kështu që i njëjti me mosveprimin e tij , ka cënuar normat morale dhe shoqërore në dhënien e ndihmës përsonave të cilët gjenden në rrezik

-me çka ka kryer veprën penale, **Mosdhënia e ndihmës nga neni 188 paragrafi 1 të KPRK**

I pandehuri L... M....

II.

Më datë 25.Janar 2024, rreth orës 00.58 min ,në fshatin Dobërcan Komuna e Gjilanit i pandehuri Lirigëzon Mustafi , me mosveprim nuk i ka ofruar ndihmë përsonit jeta e të cilit ka qenë në rrezik të drejtëpërdrejtë , ashtu që përderisa ka qenë si pasagjer në veturën e markës Golf 6 me tabela të regjistrimit 06-185-FK, të cilën e ngiste i pandehuri D... A... në anën e djathtë të rrugës ka parë veturën e markës VË Pasat me tabela të regjistrimit 06-719-AO,e cila posa ishte aksidentuar , i pandehuri vetëm ka vazhduar rrugën duke mos i ofruar ndihmën e nevojshme të dëmtuarit Besar Hoti dhe tani të ndjerit Lorent Rrustemi , edhe pse këtë ka mundur t'a bëjë pa rrezik të madh për veten apo për personin tjetër apo edhe të kërkojë ndihmë tek autoritetet përkatëse , kështu që i njëjti me mosveprimin e tij , ka cënuar normat morale dhe shoqërore në dhënien e ndihmës përsonave të cilët gjenden në rrezik

me çka ka kryer veprën penale, **Mosdhënia e ndihmës nga neni 188 paragrafi 1 të KPRK**

I pandehuri F.... A....

III.

Më datë 25.Janar 2024, rreth orës 00.58 min ,në fshatin Dobërcan Komuna e Gjilanit , i pandehuri F....A.... , me mosveprim nuk i ka ofruar ndihmë përsonit jeta e të cilit ka qenë në rrezik të drejtëpërdrejtë , ashtu që në momentin që ka arritur në hyrje të fshatit Dobërcan , me veturën e tij të markës Golf 4 me tabela të regjistrimit 06-778-BL, në anën e djathtë të rrugës ka parë veturën e markës VË Pasat me tabela të regjistrimit 06-719-AO,e cila posa ishte aksidentuar , i pandehuri ka ndalur veturën e tij në afërsi të veturës së aksidentuar dhe vetëm e ka shikuar veturën ,e më pas ka vazhduar rrugën , duke mos i ofruar ndihmën e nevojshme të dëmtuarit Besar Hoti dhe tani të ndjerit L... Rr.... , edhe pse këtë ka mundur t' a bëjë pa rrezik të madh për veten apo për personin tjetër apo edhe të kërkojë ndihmë tek autoritetet përkatëse , kështu që i

njëjti me mosveprimin e tij , ka cenuar normat morale dhe shoqërore në dhënien e ndihmës personave të cilët gjenden në rrezik

-me çka ka kryer veprën penale, **Mosdhënia e ndihmës nga neni 188 paragrafi 1 të KPRK**

Andaj, gjykata në bazë të neneve 7, 17, 21, 38, 40,42,43,44, 69,70,71,72,79, 107, dhe 188 paragrafi 1 të KPRK-së, si dhe neneve 365 dhe 452 të KPPRK-ës.

I D Ë N O N

Të pandehurit **D...A..., L... M. dhe F...A...** me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve, ashtu që me propozimin dhe me pëlqimin e të akuzuarve si dhe në kuptim të nenit 44 të KPRK-së, dënimi i shqiptuar me burgim i' u **ZËVENDËSOHET** me dënim me gjobë në shumën prej **3500 € (tremijë e pesëqind - euro)**, të cilin gjobë secili veç e veç, janë të obliguar ta paguajnë në tri rata pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse të pandehurit e lartshënuar nuk dëshirojnë ose nuk mundën që ta paguajnë dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do t'iu zëvendësohet në dënim me burgim ashtu që 1 (një) ditë burgim do t'i llogaritet për çdo 20 euro, të dënimit me gjobë.

Në dënimin e shqiptuar të pandehurve ka për t'ju llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data **26.01.2024 deri më datën 12.03.2024**.

Ndërsa të pandehurit Dionit Abdylit ka për t'ju llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data **28.01.2024 deri më datën 12.03.2024**.

Obligohen të pandehurit secili veç e veç që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 20 € (njëzet) euro, dhe për shpenzimet e ekspertizës së ekzaminimit të gjendjes teknike të automjetit në shumë prej **900 € (nëntëqind euro)**, të ekspertizës së komunikacionit **380€** dhe të ekspertizës mjeko ligjore në shumë prej 20 € (njëzet euro) të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 1300 € (njëmijë e treqind euro), ashtu që të pandehurve secilit veç e veç i bie që të paguajnë shumën prej **433.00 € (katërqind e tridhjetë e tri euro)**, si dhe **30 € (tridhjetë euro)** për kompensimin e viktimave të krimit dhe shpenzimet e procedurës sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës.

A r s y e t i m

Ecuria e procedurës

Prokuroria Themelore në Gjiilan - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.204/2024 të datës 29.02.2024, kundër të pandehurve dhe nga fshati Pogradjë K. Gj..., për shkak të veprës penale

Mosdhënia e ndihmës nga neni 188 paragrafi 1, të KPRK dhe ka propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënim meritot sipas ligjit.

Në shqyrtimin fillestar të datës 12.03.2024, ishin prezent Prokurorja e Shtetit Rozelida Manastiri dhe të pandehurit me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av. me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av. në të cilën seancë i pandehurit pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, kanë deklaruar se e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën janë akuzuar, dhe se e pranojnë fajësinë për kryerjen e veprës penale.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurve e lartcekur për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohen, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se të pandehurit e kanë kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht duke u konsultuar me mbrojtësit e tyre se të pandehurit nuk kanë qenë të detyruara ose të shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se të pandehurit fshati Pogragjë K. Gjilanit, e kanë kryer veprën penale Mosdhënia e ndihmës nga neni 188 paragrafi 1, të KPRK-së, në kohën vendin dhe mënyrën e përshkruar si në pikat I, II dhe III të dispozitivëve të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratës se të pandehurve, i ka shpallur fajtor të pandehurit Dionit Abdyli, Lirigëzon Mustafi nga fshati Dobërçan dhe Fidan Arifi nga fshati Pogragjë K. Gjilanit, sipas dispozitivëve I, II dhe III sepse kanë kryer veprën penale, Mosdhënia e ndihmës nga neni 188 paragrafi 1 të KPRK-së ngase veprimet e të njëjtëve i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtit janë dhe penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se të njëjtit e ka në pranuar edhe vet.

Në bazë të nenit 188 paragrafi 1 i KPRK-së, Mosdhënia e ndihmës konsiderohet:

1. Kushdo që nuk i ofron ndihmë personit jeta e të cilit ndodhet në rrezik të drejtpërdrejtë, edhe pse këtë ka mundur ta bëjë pa rrezik të madh për veten apo tjetrin, dënohet me burgim deri në një (1) vit.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit, ka vlerësuar se të pandehurit me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve, të zëvendësuar me dënim me gjobë në shumën prej 3500 € (tremijë e pesëqind - euro), ky dënim do të jetë një dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale. Me rastin e matjes së dënimit për të pandehurit, gjykata ka

marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuara në nenin 69 dhe 72 të KPRK-së, Kështu, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka zbutur dënimin dhe ndaj të pandehurve ka shqiptuar dënim nën minimumin e posaçëm, është fakti se të pandehurit e kanë pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, se pranimin e fajësisë e kanë bërë në të gjitha fazat e procedurës penale, se të pandehurit janë penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre penale, janë të moshës relativisht të re, kanë premtuar se nuk do të kryejnë vepra tjera penale, është hera e parë që kanë ra ndesh me ligjin, mosha e tyre. Ndërsa, rrethanë rënduese gjykata ka marrë për bazë shkallën e përgjegjësisë penale rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale dhe mënyrën e kryerjes së kësaj vepre penale të cilin e kanë bërë me dashje, pasi që të njëjtit me mosveprimin e tyre kanë cenuar normat morale dhe shoqërore në dhënien e ndihmës personave të cilët gjenden në rrezik për jetë, të cilin veprim të njëjtit me dashje nuk i kanë ofruar ndihmën e pare mjeksore e pse e kanë ditur se të njëjtit janë në rrezik të jetes ku një person nga mos veprimi i tyre ka ndruar jetë.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Gjykata, ka konstatuar se me dënim e shqiptuar ndaj të pandehurve të lartcekur sipas nenit 38 të KPRK-së, konsiston në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurit, gjykata, duke u bazuar në nenin 453 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurit t' a detyrojë për t'i paguar shpenzimet e procedurës penale, dhe paushallin gjyqësor, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr. 120/2024, më 14.03.2024

Bashkëpunëtorë Profesionale,

Shqipe Latifi

Gjyqtari,

Veli Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2024:031889
Datë: 27.03.2024
Numri i dokumentit: 05510946